

Editorial/

RAMAZANI SI NGJARJE E MADHE

Me Emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit

Një ngjarje e madhe shumë shpejt do të ndodhë në tokë, një ngjarje që do të ndryshojë dimensionet e globit me lejen e Allahut a.xh. duke e çuar atë drejt një gjendje qetësie, tolerance dhe rehatie. Ajo është një ngjarje që e mbush njerëzimin me qetësi, falje dhe mëshirë, pastron gjynahet e besimtarëve, ngren lart gradën e njerëzve të devotshëm, lehtëson barrën e fukarenjve, pastron pasurinë e të pasurve dhe hap hambaret e mëshirës së Allahut që zbret për robërit e Vet të mirë.

Ajo ngjarje është Ramazani, miku ynë i shtrenjtë me të cilin na ka nderuar Allahu, në mënyrë që të mbajmë frymën nga gara që kemi nisur për dynjaneë për të kaluar disa çaste me Allahun e Lartësuar. Ndryshe mund të themi se do të kalojmë pak kohë për t'i përgjigjur thirrjes së Zotit të botëve, që na ka përgatitur një gosti të madhe me mirësi të shumëllojshme që kurrë nuk i kemi parë më parë. Ndër këto mirësi që i shohim vetëm në Ramazan është hapja e dyerve të Xhenetit përgjatë gjithë muajit, sepse i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Kur hyn Ramazani hapen dyert e Xhenetit." Buhariu dhe Muslimi. Qartësisht kuptojmë se dyert e Xhenetit nuk janë të hapura gjatë gjithë vitit, por në muajin e Ramazanit Allahu a.xh. na ka nderuar duke i hapur ato gjatë gjithë këtij muaji. Është mirësi e madhe që Xheneti, ky vend i mrekullueshëm që ka zaptuar mendjet e muslimanëve, të jetë i hapur gjatë gjithë vitit, me aromën e tij të mirë që parfumos ambientin e gjithë njerëzimit. Këtë ndikim e shohim të kristalizuar në jetën tonë të përditshme, ku mbizotëron qetësia, lumturia, shpresa

dhe kënaqësia. Të gjitha këto janë prej mirësisë së aromës që hedh Xheneti mbi ne në tokë.

Një mirësi tjetër me të cilin na ka nderuar Allahu është mbyllja e dyerve të Xhehenemit. Profeti a.s. thotë: "dhe mbyllen dyert e Xhehenemit." Buhariu dhe Muslimi. Kjo do të thotë se dyert e Xhehenemit nuk janë të mbyllura përgjatë vitit, por mbyllen vetëm në këtë muaj bujar. Vetëm ky fakt përbën një mirësi të madhe, që ka ndikim të madh mbi njerëzit në tokë, sepse nga Ebu Dheri r.a. përcillet se i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Zhegu i madh është prej shfryrjes së Xhehenemit." Buhariu dhe Muslimi.

Duke i mbyllur dyert e Xhehenemit Allahu i Lartësuar na mbron nga shfryerja e tij, po kështu edhe nga e ftohtësia e tij. Nga Ebu Hurejre r.a. përcillet se i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Zjarri u ankua te Zoti i vet dhe i tha: "O Allah, unë po ha veten time, prandaj me lejo që të marr frymë një herë në dimër dhe një herë në verë." Prandaj në këtë kohë është nxhetësia më e madhe dhe e ftohti më i madh që do të ndjeni." Buhariu dhe Muslimi.

Madje nxehtësia e Xhehenemit reflektohet edhe në temperaturën e trupit. Nga Ibn Omeri r.a. përcillet se ka thënë: "Temperatuara është prej shfryrjes së Xhehenemit, prandaj fikenit atë me ujë." Buhariu dhe Muslimi. Për këtë arsye mbyllja e dyerve të Xhehenemit në Ramazan është një prej mirësive të Allahut përmes së cilës Ai na largon të nxehtin dhe të ftohtin. Shikoje pra se si mëshira e



Allahut a.xh. e tejkalon kufirin e të padukshme dhe reflektohet në botën reale.

Mirësia e tretë e kësaj gostie të Allahut për muajin e Ramazanit është lidhja e shejtanëve. I dërguari i Allahut a.s. thotë: "...dhe shejtanët lidhen me zinxhirë."

Lidhja e shejtanëve në Ramazan i jep muslimanit një veçori më tepër, që e ndihmon në adhurimin e tij, sepse armiqtë e tij të përbetuar dhe që i qëndrojnë më afër tashmë janë të lidhur. Nga Safija, e bija e Hujejas, përcillet se i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: "Shejtani lëviz tek njeriu ashtu siç lëviz gjaku." Buhariu dhe Muslimi.

Për këtë arsye muslimanit i është dhënë rasti që të shtojë adhurimet dhe lidhja e shejtanëve pakëson mundësinë për të bërë gjynahe, krime dhe ligësi në shoqëri. Në këtë mënyrë shoqëria është më e qetë dhe i bindet normave.

Me gjithë këto mirësi Allahu a.xh. na bën të ndjemë se muaji i

Ramazanit është i dalluar, se ai është një kohë e begatë e jetës së botës. Ngjarjet që përmenden në hadith ne nuk i kemi parë, por ato ekzistojnë në këtë univers të gjerë; Xhenetet e gjëra sa gjërësia e qiellit dhe e tokës hapin dyert e tyre dhe flakët e Xhehenemit mbyllen në shenjë mëshire për robtë, shejtanë rebelë që lidhen me zinxhirë etj., të gjitha këto janë dhuratë me rastin e ardhjes së këtij muaji të madh.

I dërguari i Allahut a.s. i uronte sahabët për ardhjen e Ramazanit dhe i këshillonte që ta përcillnin atë me adhurim. Nga Enes bin Maliku r.a. përcillet se ka thënë: "Erdhi Ramazani dhe i dërguari i Allahut a.s. tha: "Ju ka ardhur ky muaj. Në të gjendet një natë që është më e mirë se një mijë muaj. Kush privohet prej saj është privuar prej gjithë mirësisë. Prej mirësisë së saj privohet vetëm një i privuar." Ibn Maxheh.

Në këtë mënyrë shpirti i sahabeve përmallohej për këtë muaj të madh të mbushur me shpërblime.

LHSH MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
 IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
 Llogaria në lekë:
 IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
 Llogaria në Euro:
 IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
 Llogaria në Dollarë:
 IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
 Tel: 0672304520 / 0672538334 / 048320160
 BKT Banka Kombëtare Tregtare
 Nr. i llogarisë : 52416329

Fq.3/ Histori / Udhëtimi i jetës drejt vdekjes për t'u ringjallur
Nga hoxhë Migen Matraku

Fq.5/ Ramazan / Dobitë shëndetsore të

Agjërimit

.....Nga Dr. Petrit Leka

Fq.6/ Ligji ekonomik islam - Qenia njerëzore dhe natyra

..... Nga P. P. Abdurrezak

Fetva/

Subjekti: Abortimi i fetusit të deformuar

Akademia e Fikhut Islam me qendër në Mekë

L avdia i takon Allahut, të vetëm e të pashoq, paqja dhe bekimet qofshin për Profetin tonë Muhamed, pas të cilit nuk ka profet tjetër. Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam, nën Ligën e Botës Islame në sesionin e saj të dymbëdhjetë të zhvilluar në Mekën e Nderuar, në periudhën ndërmjet 15-22 Rexheb 1410 h. /10-17 Shkurt 1990 shqyrtoi temën e paraqitur më sipër dhe pas diskutimeve rreth kësaj çështje, nga anëtarët e Asamblesë dhe nga mjekët specialistë që prezantuan për këtë çështje, vendosi me shumicë vendosi si më poshtë:

-Nëse barra ka mbushur njëqind e njëzet ditë, nuk lejohet aborti, edhe nëse analizat mjekësore provojnë se, fëmija do të lind me deformime trupore, por vetëm nëse provohet me një raport të hartuar nga një komision mjekësor, i përbërë nga mjekë specialistë të besuar, se vazhdimi i shtatzënisë përbën rrezik real për jetën e nënës, në këtë rast lejohet abortimi i tij, sido që të jetë fëmija me deformime ose jo, duke shmangur kështu të keqen më të madhe.

- Para se barra të mbushë njëqind e njëzet ditë, nëse provohet dhe vërtetohet nga analizat mjekësore specifike dhe mjetet laboratorike nga një komision i specializuar mjekësh të besueshëm se, fëmija është i deformuar në mënyrë të atillë saqë është e pamundur të shërohet dhe nëse ai do të lind i tillë, jeta e tij më pas do të jetë e keqe, e dhimbshme për të dhe familjen e tij, në këtë rast lejohet abortimi i tij me kërkesë të prindërve. Asambleja duke marrë një vendim të tillë i këshillon mjekët dhe prindërit të kenë frikë Allahun dhe të sigurohen mirë për këtë çështje.

Në dorën e Allahut është suksesi.

Burimi: <http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?d=1&cid=131&l=AR&cid=13>

Mjedisi dhe mbrojtja e tij në vështrimin islam

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam

Vendimi nr. 185 (11/19)

Asambleja e Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam e dalë nga Organizata e Konferencës Islamike, e mbledhur në sesionin e nëntëmbëdhjetë të saj në Emiratin e Sharikas (Emiratet e Bashkuara Arabe) në datat 1-5 Xhumadil Ula 1430 h. /26-30 Prill 2009 e.s. pasi mori në shqyrtim studimet e paraqitura pranë Akademisë rreth problematikës që ka të bëjë me mjedisin dhe mbrojtjen e tij në këndvështrimin islam dhe pasi dëgjoi diskutimet që u zhvilluan rreth tij vendosi si më poshtë:

1. Hedhja e mbeturinave të dëmshme, në çdo cep të botës, është e ndaluar (haram). Shtetet prodhuese të këtyre mbeturinave janë të detyruara t'i përpunojnë ato në vendet e tyre pa dëmtuar mjedisin. Shtetet islame nuk duhet të pranojnë që vendet e tyre të kthehen në vende ku groposen këto mbeturina.

2. Të gjitha veprimet dhe

aktivitetet të cilat çojnë në dëmtimin e mjedisit janë të ndaluara (haram), si për shembull ato që prishin ekuilibrin mjedisor, apo shfrytëzojnë burimet natyrore pa kriter duke mos u kujdesur për të ardhmen e tij. Në këtë rast duhet të veprohet sipas rregullit të Sheriatit që thotë se dëmi duhet të zhdëmtohet.

3. Është e detyrueshme që asnjë nga shtetet e botës të mos mbaj armë të shkatërrimit të masë. Duhet të parandalohet çdo veprim që çon në rrjedhjen e gazeve dëmtuese që zgjerojnë vrimën e shtresës së Ozonit dhe ndotin mjedisin. Në këtë rast veprohet në bazë të rregullave të padiskutueshme të Sheriatit që ndalojnë dëmtimin.

Asambleja gjithashtu sugjeron:

1. Të inkurajohet hapja e vakëfeve në shërbim të mbrojtjes së mjedisit, për të gjithë përbërësit e saj: tokësor, ujor dhe hapësinor.

2. Të ngrihet një komision studimor islam për çështjet e mjedisit pranë Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam, që do të ketë si

synim observimin e të gjitha studimeve dhe marrëveshjeve që merren me problematikën e mjedisit.

3. Të bashkëpunohet me komunitetin ndërkombëtar me të gjitha format që mbrojnë mjedisin dhe ndalojnë ndotjen e tij, me kusht që ky bashkëpunim të mos bjerë ndesh me dispozitat e Sheriatit islam apo të mbart dëme për vendet islame.

4. Të inkurajohen shtetet islame të aktivizojnë organizatat mjedisore të krijuara nga Organizata e Konferencës Islamike, si dhe të bashkëpunohet me organizatat mjedisore të Këshillit të Bashkëpunimit Arab dhe të Këshillit të Bashkëpunimit të Vendeve të Gjirit.

5. Të shtohet dhe nxitet me çdo mjet të mundshëm prodhimi i produkteve "miq të mjedisit".

6. Të nxitin shtetet anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike që në vazhdimësi të nxjerrin ligje dhe rregulla që mbrojnë mjedisin dhe ndalojnë ndotjen e tij. Është e nevojshme që këto ligje të shoqërohen me masa ndëshkimore për të gjithë ata që i shkaktojnë dëme mjedisit si dhe të shtohet forca mbikëqyrëse e institucioneve që mbrojnë mjedisin, për të parandaluar të gjitha aktivitetet dhe veprimet të cilat dëmtojnë elementët e mjedisit: ujin, ajrin dhe dheun.

7. T'u kërkohet institucioneve që merren me çështjet fetare në shtetet islame, që të informojnë imamët dhe predikuesit islam me të dhëna që kanë të bëjnë me mjedisin, si dhe të përhapin studime që merren me këtë çështje si dhe me mjetet e mbrojtjes së mjedisit.

8. Të përhapet kultura e përgjegjësive për mbrojtjen e mjedisit dhe rreziku që kanoset nga dëmtimi i saj, me të gjitha mjetet që përmbushin këtë synim:

a. Të ketë transmetim të rregullt të informacionit që flet për rrezikun mjedisor, në mjetet e informimit publik.

b. Të ketë edukim të vazhdueshëm për këtë çështje si brenda shtëpisë ashtu edhe në programet arsimore në të gjitha nivelet e saj.

c. T'i kushtohet rëndësi Fikhut mjedisor në studimet e Fikhut Islam nëpër fakultetet e Sheriatit dhe studimeve islame.

Allahu e di më së miri.

Burimi: <http://19sh.c-iifa.org>

Gjykimi islam për artet marciale

Pyetje: A i lejohet muslimanit të marrë pjesë në sportet që përmbajnë përleshje fizike, ku lejohet mundja e kundërshtarit duke e goditur atë në kokë dhe në trup?

Përgjigje: Nuk ka asnjë problem të mësohen sportet e ndryshme luftarake dhe të stërvitesh në këto sporte, por duke mos dëmtuar njeri. Nuk lejohet fetarisht që të zotërohen këto sporte, nëse kjo bëhet me anë të dëmtimit fizik të kundërshtarit. Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam me qendër në Mekë, në sesionin e saj të dhjetë në Sefer 1407/ Tetor 1987 të zhvilluar në Mekë gjykoj se boksi është haram, duke u argumentuar me faktin se: "Ky sport e lejon dëmtimin e lojtarit kundërshtarë deri edhe në dëmtime të rënda trupore, të cilat mund të shpien deri në verbim, thyerje, dëmtim në tru, apo edhe vdekje, ndërkohë që fituesi nuk ka asnjë përgjegjësi! E gjitha kjo shoqërohet me ovacione triumfi nga tifozët që mbështesin fituesin dhe gëzohen për humbjen e kundërshtarit. Një vepër e tillë është tërësisht e ndaluar në vështrimin islam, sepse Allahu thotë: **"Dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim"** (El-bekare, 195) gjithashtu Ai thotë: **"Dhe mos e vritni veten (dhe njëri-tjetrin)! Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju"** (En-nisa, 29).

Profeti i Islamit (alejhi salatu ue selam) ka thënë: "Nuk lejohet dëmi ndaj vetes dhe as ndaj të tjerëve." Nisur nga këto argumente dijetarët e Sheriatit kanë thënë se nëse dikush ia lejon dikujt tjetër t'ia marrë atij jetën, duke i thënë: "më vrit", atij nuk i lejohet ta vrasë dhe nëse e bën këtë gjë atëherë ai është përgjegjës për këtë vepër dhe meriton të ndëshkohet. Nisur nga kjo Akademia e Fikhut Islam vendos se: boksi nuk lejohet të quhet edukim sportiv fizik dhe as të ushtrohet si i tillë, sepse sporti është një aktivitet fizik që bazohet në ushtrimet trupore që nuk dëmtojnë të tjerët ose veten." Ky është vendimi i Akademisë së Fikhut Islam me qendër në Mekë. Ky vendim përfshin çdo sport luftarak që zhvillohet me dorë ose me pjesë të tjera të trupit dhe që shkakton dëme apo ushtrimi dhe perfeksionimi i tij bëhet shkak për dëmtime fizike.

Allahut i takon dija absolute.

Burimi: *Sualat el-akalijat, fq. 585, Myftinia e Egjiptit, 1434h. / 2013 e.s*

Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TERNIQLI

Redaktor përgjegjës
Roald A. HYSA

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: "Teodor Keko" Pallati Eglis, Tirane-Shqipëri
lidhjehoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160
<http://www.lidhjehoxhallareve.com>

Histori/ Udhëtimi i jetës drejt vdekjes për t'u ringjallur

Nga hoxhë Migen Matraku

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të gjithësisë dhe salavatet janë për më të mirin e pejgamberëve Muhamedin, për familjen e tij e për të gjithë shokët e tij...

Në këtë artikull nuk do të shkruaj për ndonjë temë apo çështje fetare të caktuar, por për një udhëtim të cilin e ndërmora para disa ditësh dhe destinacioni ishte një varrezë e cila ndodhet buzë kufirit administrativ të Shqipërisë me Greqinë aty ku i thuhet Qafë-Botë në një luginë e cila u shndërrua nga luginë e shpresës në luginën e vdekjes, në Kllogjer.

Po pse ky udhëtim?!

E tani dua të flas për origjinën time e më pas të futem në temë:

Unë jam Migen (Jakub) Matraku, baba i dy djemve Jusufit e Muhamedit, i biri i Gëzimimit (Zeqirit), i biri i Halidit, i biri i Zeqirit, i biri i Isait, i biri i Is'hakut nga Qyteti i Margëllit në Çamëri.

Nga sa më sipër duket qartë se unë jam musliman (elhamdulillah) aq sa dhe vetë nuk e di se kur dhe me origjinë çam.

Këto dy emra (musliman e çam) më kanë formuar si njeri në personalitetin tim, egon time, dinjitetin tim, karakterin tim, krenarinë time dhe gjithçka në qënjen time.

Në Kuran në shumë ajete njerëzit kritikohen se ndjekin rrugën e te parëve të tyre, sepse ata ishin të devijuar. Por tek ne çamët kjo gjë është ndryshe nga ajo e para, sepse të parët tanë nuk ishin të tillë. Por çfarë ishin? Unë nuk di të them se si ishin apo çfarë ishin, por di të them se në një



moment në jetën e tyre ata e ndanë veten e tyre nga gjithçka kishin me një gjest të pa kuptuar nga shumica e njerëzve të cilët nuk e njohin fenë dhe burror për të gjithë ne si muslimanë.

Të parët e mi nuk ishin te varfër, por tepër të pasur. Rridhnin nga familje me dinjitet e pozitë në shoqëri, qoftë midis tyre (me çamët), por dhe tek grekët. Pra dynjaja për ta ishte nën këmbët e tyre (këtu nuk e kam fjalën vetëm për fisin tim, por për të gjithë krahinën e Çamërisë).

Dhe vjen një kohë kur Allahu e përmbys gjithçka. Këta njerëz me gjithë këto lukse të kësaj bote u vunë në sprovë: a të ruanin këto salltanete e të humbnin fenë e tyre Islamin, apo të humbnin gjithçka kishin e të ruanin fenë e tyre.

Pasha Allahun sa herë rri e ndalem në këtë moment të jetës së të parëve të mi ndiej një krenari se unë rrjedh nga njerëz të cilët u sprovuan dhe e kaluan

këtë sprovë. Por më kaplon dhe një frikë se po të isha unë në pozitën e tyre në ato momente a do rezistoj si ata?

E pra, të parët e mi ishin muslimanë të mirë dhe lanë gjithçka që posedonin në këtë jetë vetëm për fenë e tyre Islamin.

E shumë kush do të thotë me naivitet se ata u shpërngulën nga lufta, e lufta nuk të pyet se çfarë je musliman apo diçka tjetër.

Jo! Në Çamëri ndodhi e kundërta, kur lufta mbaroi filloi sprova. Batalionet e gjeneralit famë keq Zerva rrethuan qytetet me popullsi muslimane dhe kërkuan besë të hynin në to.

Të pa besët kërkuan besë tek ata që kishin besë (Islam). Hynë në lagjet e muslimanëve me besë. U futën në shtëpitë e muslimanëve si miq e në besë. Hëngrën e pinë e u rehatuan nga buka e muslimanëve.

Por momenti fatal i sprovës erdhi!!!

Përballë bukës së atij që kishte besë u drejtua pushka e të pa besit.

E unë këtu dua të ulërij e të bërtas me sa kam fuqi, qe ta marrin vesh të gjithë shqiptarët, sepse gjithçka tregohet e vetëm kjo nuk thuhet në asnjë vend, e ne si muslimanë e kemi për detyrë të flasim se përse ngjau kjo gjëmë kaq e madhe e të mos e harrojmë kurrë.

Gjithçka filloi tek shtëpitë e hoxhallarëve, të cilët u bënë shehidët e parë të Islamit në këtë masakër. Pasi u ftuan të ndërrojnë fenë e të bëhën priftërinj erdhi përgjigja e pa prituri për qafirët e pa besë: gjithçka për ne është e zëvendësueshme vetëm Islami ynë kurrë. Doli kjo përgjigje nga zemra e një muslimani të devotshëm e të ditur siç ishte Salih Hafuzi shehidi i parë i Çamërisë martire. Ai u masakrua nuk u vra, ju prenë gjymtyrët një e nga një e deri sa e varën në çengel të gjallë duke ulëritur nga dhimbjet por vetëm atë që qafirët donin ta ndëgjonin nuk e dëgjuan kurrë por vetëm fjalën: "LA ILAHE ILLALLAH".

Deshën që popullata të tmerrohej e të tërhiqej nga shembulli i hoxhallarëve, por dhe ata i mbetën besnikë fesë së tyre njësoj si hoxhallarët e tyre.

Kjo ngjarje mund të jetë nga më unikalet sepse në të gjithë këtë fatkeqësi asnjë nuk u tërhoq nga feja e tij. Çfarë qëndrese, vetëm Islami mund ta japi këtë mundësi të qëndrosh kaq burrërisht.

E pra në Çamëri u vranë e u prenë më shumë se 7500 burra, gra, fëmijë e pleq vetëm sepse ata ishin muslimanë e nuk u tërhoqën prej fesë së tyre.

Por shkrimi im sot mori shkas nga një varrezë tjetër ku prehen mbi 2960 muslimanë të tjerë të Çamërisë të cilët nuk i vrau dora e qafirrit, por i vrau lodhja, uria, etja, vapa e pamundësia.

Dua të përmend dhe diçka tjetër këtu. Në kohën kur muslimanët e Çamërisë u futën në tokën shqiptare dhe u ulën në fushën e Kllogjerit ishte Muaji Ramazan dhe njerëzit kishin filluar të agjëronin megjithë thirjet e hoxhallarëve që të mos agjëronin, sepse kjo detyrë për ta ishte e pa mundur nga gjëndja e tyre e mjeruar, përgjigja e tyre ishte në unison: nëse do na vijë vdekja le të na gjejë të agjërueshëm. SUBHANALLAH, edhe tani që po e shkruaj këtë artikull po më dridhet dora, sepse më del para syve gjyshja ime rahmet pastë e cila më thoshte se ishte shtatëzanë

në atë kohë dhe ecte e ecte deri sa mbërriti në Kllogjer. Me thonte se atë Ramazan e fillonin agjërimin në suhur me nijet dhe e prishnin agjërimin në iftar me nijet, sepse nuk kishin asnjë gjë as për të ngrënë e as për të pirë, sepse në atë vit vapa kishte qenë tepër e ashpër. Më thonte se kishte raste që agjëronin pa ngrënë e pa pirë edhe 3 apo 4 ditë me rradhë.

Për mua sa herë e kujtoj këtë histori të Ramazanit të asaj vere shtangem dhe rri e meditoj se çfarë fuqie paska imani për muslimanin e çfarë mbështetje e fortë qënka për ne. E pra në këtë varrezë prehen njerëz të cilët e donin fenë e tyre fort dhe e dëshmuuan me jetët e tyre, Allahu i mëshiroftë.

Të parët e mi kanë qenë gjithmonë një shembull i mirë për mua, sepse tek ata shihja dashurinë për vendin e tyre, Çamërinë. Aq sa dhe ne që jemi pasardhësit e tyre e duam shumë vëndin tonë, sepse në çdo bisedë ata e shprehnin mallin e dashurinë për vendin e tyre. E ngushëllimi i vetëm për ta ishte feja nën të cilën ata gjetën strehën më të sigurtë për t'u mbështetur e për të hecur përpara. Islami ishte e vetmja gjë që mbanin kokën lart dhe na e mësuan edhe neve me plot dashuri.

Kjo është gjeneza ime, këta njerëz janë të parët e mi të cilët më bëjnë të ndihem mirë për origjinën nga jam.

E titullova këtë artikull kështu, sepse ky udhëtim u ndërmor nga një grup hoxhallarësh për dy arsye: për të bërë dua për ata që vdiqën në këtë masakër dhe për t'u folur diçka rreth Islamit të pranishmëve, për fenë e tyre dhe e të parëve të tyre.

Kështu pra ishte kjo nismë dhe ky udhëtim që u mundësua të falej namazi i xhenazes në mungesë për të gjithë këta njerëz mbas 69 vjetësh.

Para namazit u mbajt një ligjëratë për të pranishmit dhe mbas namazit u bë një dua për të gjithë popullin tonë dhe për të vdekurit tanë.

Nuk do rri pa e përmendur edhe një fakt tjetër sepse në fund të gjithë kësaj Allahu lëshoi disa pika shiu të cilat nuk ka fizikant t'i shpjegojë se nga erdhën sepse qielli ishte pa asnjë re.

Në këtë ceremoni mësova diçka se ne si hoxhallarë duhet të jemi gjithmonë shembulli më i mirë për t'u ndjekur dhe se ky popull që ne jetojmë të ftohet e ne të afrohem me ta me Islam.

Gjatë fjalës së hoxhës njerëzit të cilët ndoshta nuk kanë pasur asnjë pëvojë në jetën e tyre me Islamin filluan të thërrasin Allahu Ekber dhe në atë moment mu duk se po thonin se ne jemi bijtë e nipërit e atyre që dhanë jetën për këtë fe. E kjo na obligon akoma dhe më shumë ne si hoxhallarë që të jemi më të vëmendshëm për popullin tonë për t'i mësuar fenë e tyre, Islamin.

E ndiej çdo ditë se Islami po e ringjall këtë popull dhe ky udhëtim dashtë Allahu t'i shërbejë kësaj gjëje:

Të gjallët në udhëtim për tek të vdekurit e atje të gjejnë ringjalljen e zemrave të tyre.

O Allah të lutem Ty me Emrat e Tu të bukur të na zbukurosh zemrat tona me iman e të na bësh muslimanë të mirë. O Allah mëshiro të parët tanë e na bashko me ta në xhenetet e Tua të larta. Amin!

Shënim: E gjithë kjo që kam shkruar në këtë artikull është produkt i asaj që kam dëgjuar nga gjyshërit e mi (Allahu i mëshiroftë!).

Oaz i shpirtit / Profeti (alejhissalatu uesselam) për agjërimin dhe Ramazanin

• "Erdhi tek ju muaji i Ramazanit, një muaj i bekuar dhe i begatë. Muaj në të cilën Allahu ka bërë obligim agjërimin. Në këtë muaj hapet dyert e qiellit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe shejtanët rebelë do të prangosen. Në këtë natë ndodhet një natë që është më e mirë se njëmijë muaj. Kush nuk e arrin këtë natë (me adhurime) do të jetë i privuar nga mirësitë e saj." Ahmedi dhe Nesaiu.

• "Kush agjëron muajin e Ramazanit me besim te Allahu, dhe duke prituri shpërblimin prej Tij, do t'i falen mëkatet e mëparshme". Buhariu dhe Muslimi.

• "Pesë namazet mes tyre, xhumaja deri në xhumanë tjetër dhe Ramazani deri në Ramazanin tjetër janë shlyese të mëkateve nëse i ruheni mëkateve të mëdha". Muslimi.

• Në një hadith kudsî Allahu i Madhëruar thotë: "Çdo punë e birit të Ademit është për ta përveç agjërimit, i cili është për mua dhe vetëm unë e shpërblej atë." Më pas Profeti a.s shtoi: "Agjërimi është mburojë e kur ndonjëri prej jush të jetë me agjërim, të mos flasë me fjalë të ndyra, të mos bërtasë më kot dhe të mos veprojë punë të injorancës, e nëse dikush e fyen ose e ngacmon (lufton) le t'i thotë dy herë? "Unë jam agjërueshëm"

"Pasha atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, era e gojës së agjëruetit është më e mirë te Allahu se era e miskut. Për

agjëruetit do të ketë dy gëzime, kur të çelë iftarin dhe kur të takohet me Zotin e tij". Muslimi

• "Vërtet Xheneti do të ketë një portë e cila quhet Rejjan. Ditën e gjykimit do të thirret; "Ku janë agjëruetit (për tu futur nga kjo portë)? E pasi të futet i fundit prej tyre, kjo portë do të mbyllet". Buhariu dhe Muslimi

• "Kush çohet në netët e Ramazanit të falë namaz (teravi) me besim te Allahu dhe duke e prituri shpërblimin prej Tij, do t'i falen mëkatet e mëparshme." Buhariu dhe Muslimi.

• "Kush shtron iftar një agjëruetit do të marrë shpërblimin sikur ai që agjëron pa ju pakësuar aspak shpërblimi i agjëruetit." Tirmidhiu.

• "Kur ta çelni iftarin çeleni me hurmë se ajo është e bekuar, e nëse nuk nuk ju gjendet çeleni me ujë." Ebu Davudi dhe Tirmidhiu

• "Çohuni për syfy sepse koha e syfyrit është e begatë." Buhariu dhe Muslimi.

• "Nuk është agjërimi thjesht të privohesh nga ushqimi dhe pija. Por agjërim do të thotë të largohesh nga fjalët e kota e të pahijshme. E nëse të shan dikush ose sillet keq me ty thuaj: "Unë jam me agjërim, unë jam me agjërim." Ibn Huzejme dhe Ibn Hibbani.

Shoqëri/

DISPOZITAT E TESTAMENTIT NË ISLAM

Nga Shejh Nasir bin Muhamed el Ahmed



Të gjithë e dimë se njeriu kalon nga një etapë në tjetrën dhe nga një situatë në tjetrën përgjatë jetës. Ai kalon vështirësitë dhe lehtësitë, pasurinë dhe varfërinë, dëshpërimin dhe gëzimin, shëndetin dhe sëmundjen, forcën dhe dobësinë. Pra njeriu përgjithësisht i takojnë disa të drejta për veten dhe disa të drejta për të tjerët. Në të gjitha këto tranformime dhe kapërcime njeriu mund t'i harrojë disa të tjera që i përkasin të tjerëve siç është borxhi, amanetet etj. Për këtë arsye Allahu i Lartësuar i ka dhënë atij një rast që të mbledhë shpërblime pasi të ketë vdekur. Kjo është prej mëshirës së Allahut dhe butësisë së Tij për robin e Vet të dobët. Kjo portë dhe kjo mundësi e ka emrin testament ose ndryshe amanet. Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur ndonjërit prej jush i është afuar vdekja, nëse lë pasuri pas vetes, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejtë. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypet kryer.”** (Bekare, 180).

I Dërguari i Allahut a.s. thotë: *“Allahu jua ka dhënë sadeka kur vdisni, duke lënë një të tretën e pasurisë (si amanet), në mënyrë që të shptoni veprat e tuaja të mira.”*

Testamenti në disa raste është vaxhib, në disa raste të tjera është i pëlqyeshë, në disa raste të tjera është i papëlqyeshëm dhe në disa të tjera është

i ndaluar. Përsa i përket rasteve kur testamenti është i detyrueshëm bëhet fjalë për ato raste kur njeriu ka disa detyrime ndaj të tjerëve. I Dërguari i Allahut a.s. thotë: *“Nuk duhet për një musliman që ka diçka në pronësi për të cilën i takon që të lërë testament që t'i kalojë një natë ose dy net – dhe një trasmetim tjetër thuhet tri netë- dhe të mos ta ketë shkruar testamentin e vet.”* Ibn Omeri thotë: *“Që kur dëgjova këtë prej të dërguarit të Allahut a.s. nuk kaloi një natë dhe unë e kisha shkruar testamentin tim.”* Buhariu dhe Muslimi.

Imam Shafiu thotë: *“Njeriu që bën gjënë e duhur nuk ndahet prej testamentit të tij.”*

Kush ka detyrime para Allahut apo para robërve të Tij, siç janë zekati, borxhet, shpagimet etj. duhet të shpejtojë që t'i shlyejë ato për aq kohë sa i ka mundësitë. Në të kundërt le të lërë amanetet në mënyrë të qartë si në shkrim por edhe në domethënie, të shoqëruar me dëshmitarë, sepse kemi të bëjmë me të drejtat e të tjerëve për të cilat ai do të mbëjë përgjegjësi Ditën e Gjykimit. Në këtë mënyrë përfundimi i jetës të jetë i mirë, këto detyrime nuk do të jenë jenë barrë për trashëgimtarët dhe nuk do të shkaktojnë konflikte.

Përsa i përket testamentit të pëlqyer bëhet fjalë për rastet kur njeriu nuk ka asnjë detyrim karshi të tjerëve. Për këtë arsye është e pëlqyeshme që të lërë amanet që një pjesë e pasurisë së të tij të shpenzohet për vepra të mirë në

mënyrë që shpërblimi i këtyre veprave të mbërrijë tek ai pas vdekjes. Kjo është mëshirë prej Allahut a.xh. për robërit e Vet në mënyrë që ata të shtojnë veprat e tyre të mira. Hapësira e këtij lloji testamenti janë të shumta si p.sh. amaneti për ndërtimin e xhamiave, për ushqimin e të varfërve, shlyerja e borxheve të nevojtarëve apo pagesa e nevojave për studentët që kërkojnë dijen fetare apo që mësojnë Kuranin Famëlartë.

Testamenti nuk është i pëlqyeshëm për atë njeri që ka pak pasuri, që ka shumë trashëgimtarë apo që ka trashëgimtarë të varfër, sepse është më parësore që pasuria të mos preket dhe t'u lihet atyre, për arsye se ata e meritojnë tepër se të tjetër që të përfitojnë prej saj. Allahu i Lartësuar thotë: **“Le të frikësohen ata (në prag të vdekjes) sikur të linin pas vete pasardhës të paaftë për të cilët ata kanë frikë (si do të jetë gjendja e tyre) le t'i ruhen All-llahut (dënimet të Tij) dhe le t'ju thonë (jetimëve) fjalë prindore.”** (En-Nisa, 9).

I Dërguari i Allahut a.s. iu drejtuar Sad bin ebi Uekasit me fjalët: *“Të leshë pas trashëgimtarë të pasur është më mirë se t'i leshë ata të varfër duke i lypur njerëzve.”* Buhariu dhe Muslimi.

Shabiu – Allahu e mëshiroftë thotë: *“Nuk ka shpërblim më të madh sesa një pasuri e lenë nga njeriu për fëmijët e tij që të mos ia kenë nevojë njerëzve. Shumë sahabë kanë vdekur pa lënë pas tyre një testament.”*

Ndalohet që testmaneti të lihet për gjëra të ndalauara apo bidate, si p.sh. testamenti për ndërtimin e kishave, për tempujt e idhujtarëve, për ndërtimin varreve apo tyrbeve që adhrohen, për qefinët e mëndafshhtë apo për t'u varrosur brenda në xhami apo në një shtëpi të veçantë. Të tilla teste ndalohet që të zbatohen nga pasardhësit.

Gjithashtu nuk lejohet që testamenti ta kalojë kufirin e një të tretës së pasurisë, për arsye se çdo shtesë mbi një të tjetër është e drejtë e trashëgimtarëve. Testamenti lejohet ta kalojë kufirin e një të tretës për ata njerëz që nuk kanë trashëgimtarë, madje ata kanë të drejtë që ta lejnë të gjithë pasurinë me testament.

Gjithashtu nuk lejohet që testamenti t'i dedikohet njerit prej trashëgimtarëve, që do të thotë se nuk mund t'i lihet testament një personi që ka të drejtën e trashëgimisë prej pasurisë tende. Argument për këtë është thënia e të dërguarit të Allahut a.s.: *“Nuk ka testament për trashëgimtarin.”* Ahmedi, Ebu Daudi dhe Tirmidhiu.

Gjithashtu njeriu që përfiton nga testamenti nuk mund të bëhet pronar i asaj pasurie derisa të vdesë personi që ka lëshuar testamentin, për arsye se ky i fundit mund të ndryshojë mendim dhe kthehet nga vendimi që ka marrë më parë. Për këtë janë pajtuar njerëzit e dijes.



HADITHI NR 5 :

Ibn Abasi ka thënë: Ebu Musa el-Eshariu tha: *“Aliu ishte padyshim i pari që e pranoi Islamin me të Dërguarin e Allahut (s). Hakimi shton: “Ky hadith është i saktë (sahih) nga zinxhiri (sened).”*

GRADA E HADITHIT: Këtë thënie të Ebu Musa Esh'ariut e transmeton Hakimi në “El-Mustedrek” 3/465, ndërsa saktësimi i Hakimit nuk është me vend, ndërkohë dijetarët kanë folur për tolerancën e theksuar të Hakimit në saktësimin e haditheve.

Në zinxhirin e këtij transmetimi gjendet Jahja ibn Selemeh ibn Kuhejli të cilin e kanë klasifikuar si tepër të dobët shumë dijetarë si Buhariu, Ibn Meini, Ebu Hatim Errazi, Tirmidhiu, Nesaiu, Darekutni, etj. Po ashtu në zinxhirin e transmetuesve gjendet dhe El-Hasen ibn Ali ibn Uthman të cilin e dobësojnë si transmetues disa dijetarë të tjerë, ndërkohë në zinxhir ndodhen dhe transmetues të tjerë të panjohur.

HADITHI NR 6:

Transmetohet nga Amr Mawla Afreh i cili ka thënë se: Muhammed ibn el-Kurzain e pyetën: *“Kush e pranoi i pari Islamin, Aliu apo Ebu Bekri? Ai u përgjigj: Subhanallah! Aliu ishte i pari nga ata të dy që e pranoi Islamin. Kjo çështje i ngatërroi disa njerëz sepse Aliu e fshehu besimin e tij nga Ebu Talibi, kurse Ebu Bekri e deklaroi*

haptazi Islamin. Por sipas nesh s'mund të ketë asnjë dyshim se Aliu ishte i pari prej tyre që e pranoi Islamin.”

GRADA E TRANSMETIMIT: Së pari thënësi nuk është Muhamed ibn el-Kurzai, por Muhamed ibn Ka'b el-Kuredhi, i cili është prej tabiinëve. Sidoqoftë këtë transmetim e përcjell Ibn Abdul-berri në “El-Isti'ab fi ma'rifetil-as'hab” 1/336 dhe në zinxhirin e këtij transmetimi ndodhet Abdusselam ibn Salih Ebussalt për të cilin imam Darekutni dhe të tjerë thonë se është gënjeshtar i cili ka trilluar edhe hadith në emër të Profetit (alejhissalatu uesselam).

HADITHI NR 7:

Umer ibn el-Khattabi ka thënë: *“Nuk do të arrini Aliun në tre gjëra, sepse e kam dëgjuar të dërguarin e Allahut (s) të thotë tre gjëra (për Aliun) që sikur unë të kisha vetëm njërin prej tyre,*

do të ishte më e shtrenjtë për mua se gjithçka mbi të ciliën lind dielli. Isha te Profeti (s), së bashku me Ebu Bekrin, Ebu Ubejdeh ibn ul-Xherrahin, dhe disa shokë të tjerë të Profetit (s), kur ai i ra në sup Aliut me dorën e tij dhe tha: *“Ti je i pari ndër njerëz që e pranoi Islamin! Ti je i pari i njerëzve në iman! Ti je për mua si Haruni për Musain!”*

GRADA E HADITHIT: Këtë hadith e transmeton Ibn Asakir në: *“Tarih Dimeshk” 42/167* dhe në zinxhirin e tij ndodhen Me'muni, Harun Rashidi, Mehdiu, Mensuri, prej familjes së dinastisë Omejade të cilët nuk shquhen për transmetime hadithesh, madje mes tyre dhe ibn abbasit që përcjell këtë nga Umeri ka transmetues të tjerë të panjohur të cilët e bëjnë hadithin të dobët, aq më tepër kur ky hadith nuk ruhet në koleksionet e transmetimeve të hadithit dhe as që ka transmetues të besueshëm.

Ramazani/

DOBITË SHËNDETSORE TË AGJËRIMIT

Nga Dr. Petrit Leka



O ju që besuat ua kam bërë obligim agjërimit ashtu si dhe te tjerëve para jush, që te bëheni te devotshëm.

“O ju njerez po ju vjen nje muaj i madhërishtëm ne te cilin filloi shpallja e Kuranit libri hyjnor i Zotit, kush e arrin ne te le ta agjeroje.” “Nga të gjitha punët e mira që ben robi (njeriu) te gjitha i ben per vete ndërsa agjerimi është per mua dhe une per te shperblej.” Me këto fjale u drejtohet Allahu i Lartmadheruar roberve te tij te dashur.

AGJËRIMI: Fjala (agjërimit) ka kuptimin: qëndrimi pa ushqim e ujë, heshtje, qetësim, përmbajtje, heqje dorë, shijim etj. Kuptimi thelbësor i kësaj fjale është “të bëhesh i qetë”, te durosh, te ndërpresësh ushqimin, ujin; te ndryshosh ne këtë muaj te madhërishtëm mënyrën e jetesës, pra te sakrifkohesh per hir te diçkaje te larte hyjnore, te zbatosh nje urdhër te Zotit që kënaqet me te devotshmit dhe ju premton atyre shperblim ne te dy botet; ne kete bote kenaqesine e Iftarit, shendetet qe eshte kushti kryesor i një jete te lumtur, jete te gjate te gezuar cilesore, mbrojtje nga semundjet dhe ne boten tjetër kopshtet e mrekullueshme te Xhenetit, qe syri nuk i ka pare dhe mendja nuk arrin t'i përfytyrojë.

Agjërimit është i njohur historikisht me fillimin e jetes se gjalle ne toke, si per qeniet njerezore ashtu dhe per qeniet e tjera te gjalla, p.sh. ndërprerja e ushqimit gjate nates, apo disa kafshe qe bejne gjumin e dimrit, ose nderpreja e ushqimit kur dikush semuret. Nje nga shenjat e semundjes eshte mungesa e deshires per te ngrënë (anoreksia), si nje mekanizem mbrojtës per t'i lene kohë trupit te qetësohet dhe te largoje produktet toksike te krijuara gjate metabolizimit te lendeve ushqimore nga kequshqyerja, apo zhvillimi i nje semudje te caktuar.

Agjërimit është disa llojesh: i pjesshem dhe i plote. (p.sh. ndalimi i disa ushqimeve sipas semundjeve perkatese apo sipas religjioneve: hebraik, kristian, budist, grevat e urise); i plote si agjërimit Ramazanit. Agjërimit mund te jete i nderprere: nje dite po nje dite jo; ne dite te caktuara: e Hene, e Enjte; 3 netet e Henes se plote; Dita e Ashures; etj. Ne te gjitha rastet agjërimit është i dobishem per shendetin dhe adhurimin ndaj Zotit, qe na ka dhuruar jeten dhe gjithë te mirat e tjera qe gëzojme.

Agjërimit ne muajin e Ramazanit është nje kusht themelor i besimtarit mysliman, si një nga format me te larta te adhurimit, por qe ai te jete i pranuar ka disa rregulla zbatimi i te cilave është i lidhur dhe me gjendjen shëndetësore, moshen, seksin, gjendjen mendore etj.

Sa i përket agjërimit ne muajin e Ramazanit, kushtet për kryerjen e këtij obligimi janë që: personi të jetë musliman, të ketë arsye të shëndoshë, të mos jetë udhëtar, të mos jetë i sëmurë, nëse është femër mos të jetë me të përmuajshmet (zakonet) apo lehone, por pas kalimit të asaj gjendjeje duhet ta agjërojë numrin e njëjtë të ditëve të lëna). Po ashtu edhe udhëtar është i liru nga ky obligim, por Kurani e plotëson këtë duke thënë: “Por, të agjëroni është më mirë, ta dini”. Për sa i përket te semurit duhet ditur, se megjithese agjërimit është shprehur edhe si metode kurimi duhet patur parasysh, se ne kete rast ka te beje graviteti i sëmundjes, p.sh., ne sëmundjet e renda ku lejohet pakesimi i sasise se ushqimit, por jo nderprerja e zgjatur e marrjes se ushqimit. Ne këtë rast behet kompesim ushqimi ditor i nje te varfri. Ndersa ne semundjet kronike, si psh., Gastriti, Ulcera e stomakut, semundjet e lekures, diabeti tip 2 etj., lejohet agjërimit per adhurimin e Zotit, por duke ndjekur disa rregulla, si lloji i ushqimit, ngrënia e detyruar e syfryt, marrja e lengjeve, reduktimi i aktiviteti fizik, kontrolli mjekesor etj.

Agjërimit ne fene islame ka per qellim lartsimin shpirtor, edukimin moral, pergatitjen e njeriut per te perballuar tundimet e veshtiresite e jetes, qe ta meritoje shperblimin dhe meshiren e Zotit. Ne kete veshtrim çdo njeri qe beson dhe është mysliman e ka deshire ta perjetoje kete muaj te madherishem me agjërimit, por ka disa kushte qe ai nuk mund te agjeroje.

“E ata qe i rendon ai (nuk mund te agjërojnë). Te tille jane fëmijët nen moshen 13 vjeç, te semuret me te meta mendore psiqike, pleqte e moshuar, te semuret me semundje akute, te cilet pas sherimit i zevendesojne ato dite, te semuret me semundje te renda afer fundit te jetes se tyre (kanceri, semundjet e zemres e te trurit etj). “Allahu me kete deshiron lehtesim per ju e nuk deshiron veshtiresim per ju”- thote Zoti ne Kuran.

Me gjithë perparimet e medha qe ka arritur shkenca mjekesore moderne, si ne drejtim te zbulimit te aparatave moderne te diagnozes, aplikimit te metodave kirurgjikale me precizion te larte, zbulimit te medikamenteve te reja, si hemoterapia, radioterapia per disa, e mjekimit e shume semundjeve te tjera, vaksinat, antibiotiket akoma ngelen problem semundje degjenerative te sistemit nervor, aksidentet etj. Problem mbeten aksidentet ne rrugë te

lidhura me alkoolin, drogen, vete alkoolizmi, te lidhura keto me menyren e jeteses etj.

I Derguari i Allahut s.a.v.s ka thene: “Agjërimit është mburoja qe ju ruan”, d.m.th agjërimit është jo vetem akt i devotshmerise, qe e çon robin afer Zotit te vet, por dhe e ve nen mbrojtjen e Allahut (xh. sh). Pra per trupin sherben si dietoterapi, qe realizon nje gjendje fiziologjike normale te mire, funksionimin te organeve, zemren e lehteson e pastron dhe e vendos ne varesine e plote ndaj Allahut te Gjithëfuqishëm.

Sot problemi i madh qe qendron para shoqerise njerezore është si te parandalohen semundjet pa mjek, pa kirurgji, si te ndjehesh me i ri me shume energji, si te evitohet stresi, obeziteti, semundjet vaskulare etj. Agjërimit konsiderohet me shumë dobi, si për nga ana shpirtërore, ashtu edhe ajo shëndetësore, por edhe studimet shkencore ne mjekesi; si dhe ato statistikore, studime klinike ne laborator, ne njerëz dhe ne kafshe çdo dite e me tepër vërtetojnë vlerat e medha te agjërimit te zgjatur ne ruajtjen e shendetit, parandalimin e semundjeve ne jetegjatesine cilesore, ne pleqerine aktive e te shendeteshme.

Studime te kryera per agjërimit tregojne per vlerat e medha shendetesore. Ajo qe është e re ne keto studime klinike është konstatimi qe agjërimit ndikon jo vetem ne ruajtjen e shendetit, por dhe ne jetegjatesine, apo kur agjërimit ne peridudha me te gjata per arsye te ndryshme dhe me vlera te jashtezakonshme kur behet si adhurim i Zotit si obligim fetar.

Te dhenat tregojne se kur agjërimit kryhet sipas rregullave te caktuara agjerusi ndjehet mire, por dhe ne ekzaminimet laboratorike jane vene re keto ndryshime fiziologjike:

Duken me mire, ndjehen me mire, jetojne me gjate etj: Ne gjak –ulet niveli i yndyrnave, triglicerideve dhe kolesterolit, ulet TA nepermjet ndryshimeve te aktivitetit sistemit nervor.

Kemi permiresim deri ne sherim te plote te tregusve inflamatore (provat reumatizmale, sedimenti Fibrinogjeni treguesit imunologjike etj., po keshtu ne studime jane vene re ndryshime deri dhe tek ADN-ja. Reduktohet me shume mekanizma rreziku i kancerit dhe per kete flet fakti qe kanceri takohet shume rralle tek ata qe bejne jete te rregullt fetare, falin namazin e agjerojne.

(Kanceri sot konsiderohet si nje semundje e shkaktuar nga shume faktore: stresi, kequshqyerja, alkooli, duhani, viruset, myket, rrezatimi jonizues etj). Gjate agjërimit ne muajin e Ramazanit sigurohet qetesia, kryhen me te plota adhurimet, permiresohet menyra e ushqyerjes pasi ushqimi merret ne orar te caktuar plotesohet bioritmi i jetes.) Kryhet ne menyre perfekte riparimi qelizor, realizohet oksidimi i acideve yndyrore, rritet shkalla e lirimit hormonal.

Vihet ne kontroll oreksi (ndoshta permes ndryshimeve ne GHRELIN HF) krijohet kushte per kontrollin e glukozes, duke permiresuar prodhimin e insulines, dhe ulur rezistencen ndaj saj.

Qetesohen zemrat pra permiresohet funksioni i zemres dhe qarkullim te gjakut Permiresohen funksionet e trurit

dhe sistemit nervor, permiresohet tretja e ushqimeve, permiresohet funksioni i veshkave dhe prodhimi hormonal te gjitha keto te lidhura me Agjërimit, pasi ne muajin e Ramazanit kryhen ne 3 veprime kryesore: Adhurimi i Zotit, ekuilibrohet regjimi ditor dhe rregullohet ushqyerja.

DISA SEMUNDJE QE KUROHEN ME AGJËRIM JANE:

1- Semundjet sociale si: lenia e duhanit, lenia e alkoolit, droges, heqja dore nga lojrat e fatit, llotarite, bixhozi etj. Te gjitha keto jane me efekte ne shendetin mendor.

2 –Obeziteti: semundje qe është problem ne shoqerine e sotme e ardhur si nga faktore trashëgimie, por e lidhur dhe me mbiushqyerjen.

3-Diabeti tip2: konsiderohet si semundje e lidhur me menyren e jeteses dhe mbiushqyerjen pa aktivitet fizik. (gjate agjërimit te ramazanit si rezultat i urise ose uljes se niveli te sheqerit (glukozes) ne gjak organizmi fillon te djege rezervat dhjamore ne trup duke ulur rezistencen ndaj insulines dhe rritjen e prodhimit te saj, ne te njejtën kohe largohet dhe zakoni i ngrënies se tepert apo mbingopjes, qe është nje nga shkaqet e diabetit dhe obezitetit qe shpesh jane bashke.

4- Semundjet e stomakut apo te zorreve, nga qe u jepet te pastrohen dhe pas pushimit te bejne ripertitjen e tyre funksionale dhe anatomike.

5-Me vlera te medha është agjërimit ne kete muaj per melcine dhe veshkat, dy organe me rëndësi jetike për jetën e njeriut si prodhuese te energjisë trupore dhe pastruese nga toksinat qe prodhohen ne trupin e njeriut gjate aktivitetit te tij jetesor.

Qe agjërimit te jete i suksesshem ne dobi te shendetit duhet zbatuar me rigorozitet 3 elemente kryesore:

1- Te mos neglizhohet ngrënia e Syfryt (mengezet) ne kohen e duhur gje qe ka te beje me bioritmin e rregulluar gjenetikisht. I Derguari Zotit a.s. ka thene: “Mbrojeni trupin me zgjim te hershem” koha e sabahut korrespondon me zgjimin edhe te qelizave e organeve fillon prodhimi hormoneve, fillon aktiviteti organizmit i duhet energji te punoje gjë qe arrihet me metabolizmin e ushqimit qe duhet te merret nga i cili prodhohet energji qe do t'i shërbejë trupit për aktivitet, ripërtëritje, prodhim hormoneve dhe trupeza imune. Ne te njëjtën kohe truri, zemra gjaku, veshkat preferojnë katër oret e para glukozen e mare direkt nga vakti i ushqimit. Po kështu dhe pirja e 2-3 gotave ujë 30min para ushqimit. Dhe plotësimi vaktit me ushqim te lëngshëm (fasule ,supë, me mish ,fiba fruta) deri ne bërjen e nijetit per agjërimit e dites.

2- Kryerja e namazeve te plota gjate dites duke e plotesuar me namazin e teravive pasi studimet kane vleresuar se agjërimit me levizje ruan masen muskulare, rrit djegien e shtresave dhjamore ne trup, dhe rrit prodhimin hormonal.

Gjate agjërimit sidomos ne dite e nxehta dhe te gjata te verës duhet te evitohet qëndrimi i zgjatur ne diell duke preferuar hijen dhe ambiente me levizje te ajrit. Ne disa raste vihen re dhe disa shqetësime, si dhimbje koke, përgjumësi, dobësi trupore, te cilat jane te kalueshme dhe lehtesohen nese merret syfyri dhe kryhen rregullisht namazet.

Allahu e befte te lehte agjërimit tuaj dhe ju shperblefte me te mira ne Xhenet. Amin!

Profeti
Muhamed a.s.
ka thënë: “Agjërimit
që të jeni të
shëndetshëm.”

LIGJI EKONOMIK ISLAM - QENIA NJERËZORE DHE NATYRA

Nga P. P. Abdurrezak



Nga perspektiva islame gjithçka është e pasur dhe me bollëk në këtë botë. Kjo është e qartë dhe e thjeshtë për këdo vëzhgues. Megjithëse qenia njerëzore është në epiqendrë midis miliona specieve të këtij planeti, ai nuk është as më i madhi i të gjitha specieveve, as me numrin më të madh, as me jetëgjatësinë më të madhe, as në unazën e parë të zinxhirit të gjallesave. Numri i një lloji të veçantë zogjsh shumëgjyresh migratorë, që fluturojnë nga pjesa jugore e Amerikës për në Meksikë me ardhjen e dhjetorit është 140 milionë. Ky nuk është i vetmi lloj zogu migrator nga Amerika. Porse ka edhe zogj që qëndrojnë në Amerikë dhe nuk migrojnë. Po ashtu ka zogj të tjerë në pjesën veriore, lindore e perëndimore të Amerikës gjithashtu. Si përfundim ne jemi të sigurtë, që numri i zogjve në Amerikë është shumë herë më tepër më i madh se sa i njerëzve aty. Mendo pak për peshqit në thellësitë e ujërave. Numri i një lloji të vetëm peshku mund të jetë shumë herë më i madh, se sa numri i qenieve njerëzore në këtë planet. Meditoni pak mbi llojet e ndryshme dhe numrin e stërmadh të krijesave të ujit. A mos vërehet ndonjë lloj mungese apo deficit në ushqimin e tyre, që kërcënon ekzistencën apo mbijetesën e tyre? Le të hedhim një sy në dy ajete kuranore, të cilat nxjerrin në pah këtë fakt:

“Sa e sa gjallesa janë që nuk kanë mundësi për furnizimin e vet. Allahu i furnizon ato edhe juve. Ai është Dëgjuesi, i Dijshmi.” (Ankebut, 60).

Kuptimi kryesor i këtij ajeti është, meqë Allahu është furnizuesi për të gjithë njerëzit dhe të gjitha speciet e tjera në këtë planet, si ka mundësi që natyra të jetë e pamjaftueshme dhe e varfër për qeniet njerëzore vetëm, kur ajo është e pasur dhe e bollshme për të gjitha speciet?!... Një ajete tjetër kuranor përmend se furnizimi me ushqim i të gjitha specieve, duke përfshirë qeniet njerëzore dhe ekzistenca e mbijetesa e tyre është përgjegjësi e Allahut:

“Nuk ka anjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj, Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas vdekjes).” (Hud, 6).

I Dërguari i Allahut alejhi selam tha kur i pa zogjtë tek po zhagiteshin në muzg: *“Vëreni! Ata shkuan në agim me barqet bosh. Ata u kthyen në çerdhet e tyre në muzg me barkun plot.”* Për aq sa një vëzhgues mund të shqetësohet, kjo mund të jetë një paradoks të shikosh natyrën aq të bollshme për të gjitha ato specie, qofshin ato barngrënëse apo vetëm mishngrënëse, dhe me mjete të kufizuara të na pikturohet si e pamjaftueshme dhe e varfër për qeniet njerëzore, e vetmja krijesë që ha gjithçka në këtë planet, e cila i konsumon të gjitha ato specie dhe florën e faunën si burimet e veta. Në fakt qenia njerëzore thjesht e gjen veten në faj me natyrën dhe Krijuesin e saj për keqmanaxhimin e vet dhe praktikën e këqija. Qenia njerëzore zë vetëm 23% të hapësirës tokësore me krijesat e tjera me të cilat ai konsumon 77% të burimeve të pafundme të ujit. Tashti konsideroni fenomenin e ajrit dhe të dritës së diellit, të cilat janë të pamendueshme për ekzistencën e vërtetë dhe vazhdimësinë e jetës njerëzore në këtë planet dhe në të njëjtën kohë janë përtej sferës së menaxhimit njerëzor. A mos po kalojmë ndonjë përvojë mungese apo

pamjaftueshmërie?

Kështu sistemi islam që buron nga udhëzimi hyjnor është i mrekullueshëm, unik, i paarritshëm dhe i përsosur si instinktet e kafshëve.

EKONOMIA ISLAME & PËRVETËSIMI I PASURISË

Detyrimi i dhënies së zekatit dhe marrja e tij me forcë del në pah kur një person përvetëson pasuri në një masë të caktuar. Kështu ekonomia islame, e cila fokusohet në decentralizimin e pasurisë nëpërmjet mjeteve të ndryshme dhe baraspeshimit të shpërndarjes së saj në shoqëri na mëson, se përpara rrugëve të shpërndarjes dhe shkëmbimit të pasurisë përvetësimin e saj me të drejtë dhe me mënyra ligjore. Zekati nuk është emërtimi i procesit të purifikimit të pasurisë, e cila është përvetësuar paligjshëmrisht dhe padrejtësisht. “Nesër në jetën e ahiretit, asnjë qenie njerëzore nuk do të lëvizë nga Gjykata Hyjnore e Allahut deri sa të jetë përgjigjur për pesë gjëra,” - i mëson Profeti alejhi selam besimtarët. E veçantë nga këto pesë gjëra do të jetë vetëm një. “Jetëgjatësia, çfarë bëre ti me të? Shëndeti, çfarë bëre ti me të?...” por kur të vijë puna të pasuria do të jenë dy pyetje me të cilat ne do të ballafaqohemi: pyetja e parë është: “Nga dhe si e përvetësove atë?...” dhe më pas do të vijë pyetja e dytë që ka të bëjë me pasurinë: “Si e shpenzove ti atë?” Islami e rregullon dhe e kontrollon “lirinë për” të përvetësuar dhe fituar nëpërmjet parashkrimeve, me qëllim që të sigurojë qytetarët e vet nga “liria për” të qenë të shfrytëzueshëm, të mashtruar, të gënjyer apo të grabitur. Ai nënkupton që koncepti i lirisë gëzon të drejtën e drejtësisë dhe e largon atë nga të qenit një vegël shfrytëzimi.

Në një tjetër thënie profetike Profeti na përshkruan një person të cilin njerëzit e zakonshëm e kujtonin “të devotshëm”, sepse e shihnin atë që falej në shkretëtirë. Ai i kishte të veshura të gjitha tiparet e devotshmërisë si një maskë. Profeti alejhi selam thotë: “Uji i

tij që pinte ishte i përvetësuar paligjshëmrisht, ushqimi që ai hante gjithashtu ishte i fituar paligjshëmrisht dhe rrobat që ai kishte veshur gjithashtu ishin marrë paligjshëmrisht. Atëherë si do të pranoheshin lutjet e tij?!...” Kjo do të thotë se Allahu deri edhe nuk ka për t'i pranuar lutjet nga një person, që nuk është furnizuar në jetën e tij socio-ekonomike sipas vijës së rregullave, udhëzimeve dhe urdhërimeve të Zotit.

Zekati nuk është, as një licencë për të përvetësuar pasurinë paligjshëmrisht, as edhe një mjet për të pastruar pasurinë e përvetësuar paligjshëmrisht. Zekati e çliron personin nga mentaliteti i keq i adhurimit të pasurisë, koprancia, grykësia, xhelozia, egoizmi, ngushtësia e mendjes dhe vogëlsia dhe ai fut tek njeriu mentalitetin e sakrificës, bujarinë, kujdesin ndaj të drejtave të tjetrit, bashkëpunimin social dhe bamirësinë. Nëpërmjet Zekatit, Vakufeve dhe mjeteve të tjera të tilla Islami kërkon nga qeniet njerëzore të mos jenë egocentrike. Islami propagandon që ekonomia nuk është vetëm një çështje shkencore, por gjithashtu edhe e moralit.

Ai sa është kulturor, është edhe qytetërimor. Ai ka lidhje me të dyja, si teknologjinë edhe shpirtëroren. Zekati ka nevojë të shihet jo vetëm nëpërmjet analizës objektive, por ai duhet drejtuar gjithashtu me normativën morale. Ja përse atij i është dhënë emërtimi zekat, i cili në arabisht do të thotë pastrim. Në Kuranin e Shenjtë thuhet: **Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë që t'i pastrosh me të dhe t'u shtosh (të mirat) dhe njëkohësisht lutu për ta, se lutja jote është qetësim për ta. Allahu dëgjon dhe sheh.”**

Përemri me të në këtë ajete shënon se Zekati pastron mendjen dhe jetën e personit që jep Zekat, dhe jo pasurinë e atij që jep zekat. Nëse në përgjithësi Zekati e pastron pasurinë, është vetëm në sensin që Zekati e parandalon pasurinë të bëhet e papastër dhe e panjollësuar nga përzjerja e saj me të drejtat dhe detyrimet e tjetrit që nuk dalin prej Zekatit.

NAMAZI I TERAVIVE

Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

Namazi i teravive është sunet si për meshkuj ashtu për femra. Fjala “teravi” është shumës i fjalës “teruihatun” e cila rrjedh nga fjala “rahatun”, që do të thotë çlodhje, pushim. Imam El Fejumi në “Misbahul munir” dhe imam Ibnul Mendhuri në “Lisanul arab” shpjegojnë se namazi i teravive është quajtur kështu, ngaqë muslimanët e gjeneratës së parë, kur falnin namazin e teravive pushonin pas çdo dy selamesh, pra pas çdo katër rekatësh. Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se për vlerën e këtij namazi peygamberi (alejhi selam) ka thënë: *“Kush çohet për t'u falur në ramazan (teravitë) me besim të plotë dhe duke llogaritur shpërblim tek Allahu, do t'i falen gjynahet e mëparshme.”*

Namazi i teravive falet pas namazit të jacisë dhe para namazit të vitrit në xhami me xhemat, por mund të falet edhe vetëm në shtëpi. Ai fillon një mbrëmje para ditës së agjërimit dhe mbaron një mbrëmje para ditës së Fitër Bajramit. Prej sunetit është të falen 8 rekatë, duke dhënë selam pas çdo 2 rekatësh. Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: *“Peygamberi (alejhi selam) nuk ka falur më shumë se 11 rekatë në Ramazan dhe*

jashtë Ramazanit.” Transmetoi Buhariu. Pra, 8 rekatë teravi dhe 3 rekatë namaz vitër.

Nëse ai që falet ka arritur në xhami ose në vendin që është duke u falur namazi i teravive në një pjesë të caktuar të faljes atëherë pjesën e mbetur mund ta plotësojë edhe më pas duke pasur parasysh që namazin për çdo natë duhet ta mbyllë me namazin e vitrit.

Shumica e dijetarëve të mëdhenj si imam Ebu Hanifa, imam Maliku, imam Shafiu, imam Ahmed ibn Hambeli, imam Sufjan eth Theurij, imam Ibnul Mubarek e të tjerë në kohën e tyre por edhe dijetarët e mëdhenj në shekujt e më vonë janë të mendimit se namazi i teravive mund të falet më shumë se 8 rekatë, pasi kjo gjë ka qenë e njohur te tabiinët (pasuesit e sahabëve), të cilët i kanë falur teravitë dikush 20 rekatë, dikush 36, dikush më shumë e dikush më pak. Imam El Kemal Ibnul Humami, njëri nga dijetarët më të njohur të medhhebit hanefi, thotë: *“Prej sunetit është që të falen 8 rekatë, ndërsa 12 rekatet e tjera (sa të plotësohet 20 rekatëshi) janë mustehab (vepër e pëlqyeshme).”* Për këtë që sqaruar

më lart nuk mësohet të ketë mendim ndryshe nga dijetarët islamë në tre shekujt fatlumë, madje të parët tanë të mirë (selefussalih) e kanë praktikuar vetë faljen e teravive më shumë se 8 rekatë gjë e cila është trashëguar brez pas brezi deri tek ne. Kështu myslimani është i lirë të falet sa të dojë, mirëpo më e mira për masën myslimane është që imami i teravive të dijë gjendjen e xhematit që falet pas tij, ku ka gra, fëmijë, pleq ose të sëmurë, andaj ai nëse mjaftohet me 8 rekatë këndon Kuran më gjatë, e nëse falet më shumë se 8 rekatë këndon Kuran më shkurt. Sidoqoftë, kush do që falet pas imamit një numër të caktuar mund të mjaftohet me 8 rekatë, ose më pak ose më shumë dhe mund të shkëputet edhe nëse imami vazhdon të falë më shumë dhe nuk e ka detyrë të qëndrojë pas imamit deri në fund duke qenë se vetë namazi i teravive nuk është detyrë, por thjesht mustehab. Cdo njeri mund të mjaftohet me një numër të caktuar rekatësh dhe mund të falet më vonë vetë në shtëpi. Rëndësi ka që të mundohet mos të kalojë asnjë natë prej ramazanit pa falur namaz teravi sepse Profeti (alejhissalatu uesselam) thotë:

“Kush çohet në netët e Ramazanit të falë namaz (teravi) me besim te Allahu dhe duke e prituar shpërblimin prej Tij, do t'i falen mëkatet e mëparshme.” Transmetuan Buhariu dhe Muslimi.

Namazi i teravive është i mundshëm edhe për gratë. Edhe pse namazi më i mirë për gruan është në shtëpinë e saj, siç ka ardhur në një hadith që e transmeton Ebu Daudi, kjo s'është të thotë se namazi i saj në xhami është i pavlefshëm, aq më tepër kur bëhet fjalë për namazin e teravive, i cili është një namaz i veçantë. Dalja e gruas nga shtëpia natën në xhami ka kushtet e veta. Ajo duhet të jetë e shoqëruar nga pjesëtarët e familjes së saj, të jetë e mbuluar, të mos zbulohet për njerëzit e huaj, mos të parfumohet me erëra të mira.

Është e pëlqyeshme që për namazin e teravive të merren edhe fëmijët që kanë mbushur moshën 7 vjeç, që ta praktikojnë këtë namaz me xhemat në muajin e ramazanit dhe që të marrin pjesë në begatitë dhe mirësitë që Allahu i Lartësuar zbret në këtë muaj madhështor.

Allahu na bëftë prej adhuruesve të Tij dhe na pranofte adhurimet!

Ekonomi / Pjesëmarrja në shoqëritë tregëtare nëpërmjet aksioneve të përziera

Nga Abdulatif bin Aued bin Muhamed El-Karni

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, paqaja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Zotërinë e të dërguarëve, shokët dhe ndjekësit e tij.

Aksionet e përziera janë ato shoqëri të cilat merren me aktivitet të lejuar në origjinë, por që përdorin disa transaksione të ndaluara, qofshin këto kredi me kamatë, apo investime të ndaluara, ku pjesa më e madhe e shoqërive sot i përkasin këtij formati. Ekzistojnë dy qëndrime të juristëve bashkohorë në lidhjen me marrëdhëniet me të tilla shoqëri që operojnë me kapitale të përziera. Qëndrimin e parë e përfaqësojnë një pjesë e dijetarëve bashkohorë, të cilët bëjnë dallim mes marrëdhënie të përgjithme, sidomos në lidhje me ortakërinë, ku disa prej tyre mendojnë se lejohet tërësisht bashkëpunimi me këto shoqëri përsa i përket shit-blerjes, marrjes me qera apo dhënies së borxhit. Si rrjedhojë, lejohet punësimi në të tilla shoqëri, marrja e rrogave prej saj, marrja me qera e shërbimeve të saj dhe dhënia me qera e objekteve etj., vetëm se ndalohet pjesëmarrja në aksionet dhe asetet e tyre.

Si shembull mund të japim shoqëritë e energjistikës, telekomunikacionit etj, ku lejohet marrja me qera e shërbimeve të tyre, pagesa e fatyrave të tyre, të punësuarit aty në administratë, apo në shërbime, ose puna në ruajtjen e tyre, marrja e rrogave dhe pensione prej tyre, si dhe dhënia me qera e ambienteve për të cilat ato shoqëri kanë nevojë, vetëm se nuk i lejohet askujt që të marrë pjesë në aksionet dhe asetet e saj, edhe nëse aksioneri arrin të pastojë atë pjesë të fitimit të ndaluar, në mënyrë që të mos jetë prej atyre që ndihmojnë në ngënie e haramit. Këtë qëndrim e ka mbështetur Këshilli i Përhershëm i Fetvave në Arabinë Saudite dhe një pjesë e juristëve bashkohorë. Këshilli është shprehur tekstualisht se pjesëmarrja në Banka dhe shoqëri që punojnë me kamatë nuk lejohet, edhe nëse aksioneri dëshiron të pastrojë pjesëmarrjen e tij nga kamata, dike shitur aksionet e tij në treg dhe duke marrë vetëm kapitalin e tij fillestar dhe tepricën t'a shpenzojë për bamirësi.

Grupi i dytë është i mendimit se lejohet pjesëmarrja në aksione përderisa është lejuar marrëdhënia me këto shoqëri në përgjithësi përsa i përket origjinës së shoqërive të përziera, me kusht që kapitali i përzier të mos jetë i shumtë por i pakët dhe natyrtisht jo i pavarur, nisur nga origjina e përgjithshme në aktivitetin e lejuar të shoqërisë. Vetëm se ky grup ka patur mospajtime rreth kufirit që përcakton të paktën e tolerueshme në transaksionet e ndaluara dhe në përcaktimin relativ të përllagaritjes së të paktës në fletoret e llogarisë dhe në treg, si dhe kanë patuir mospajtime rreth mënyrës sesi mund ta pastrohet pjesa e ndaluar. Këtë qëndrim e ka mbështetur Shejh Muhamed bin Saleh el-Uhejmin, Allahu e mëshiroftë dhe Shejh Abdullah bin Muniu, si dhe pjesa më e madhe e këshillave mbikëqyrës të aktivitetëve bankare, siç është Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë së Raxhahit.

Shejh Uthejmini thotë: *“Nëse një person është bërë aksioner apo dëshiron të jetë i tillë, pa zgjedhur rrugën e devotshmërisë dhe kujdesit, atëherë ne themi se zgjidhja në të tilla raste është se, nëse paraqiten fitimet në një listë që sqaron burimet e fitimit, atëherë nëse burimi është prej hallallit atëherë fitimi është hallall dhe nëse është prej haramit, atëherë fitimi është*

haram, si p.sh nëse ata deklarojnë se këto fitime vijnë nga interesi bankar, në këtë rast personi e ka për detyrë që të pastrojë këto të ardhura me sadeka, jo duke kërkuar shpërblimin tek Allahu, por si pastrim nga gjynahu i saj.”

Përsa i përket arsyes të atyre që e ndalojnë pjesëmarrjen në shoqëritë aksionere me kapital të përzier, ai është Bordi Drejtues i shoqërisë, të cilët kanë pushtetin e plotë për të vepruar me pasurinë e shoqërisë dhe në transaksionet e saj, ku juristët mbajnë qëndrime të ndryshme rreth dhënies së pasurisë dikujt që e vë në punë atë, por që merret me transaksione të ndaluara, të janë ndarë në medh'hebe, ku dikush shprehet se lejohet por nuk është e pëlqyeshme, e ky është qëndrimi i pjesës më të madhe të dijetarëve hanefi, shafi dhe hambeli dhe të tjerë përveç tyre. El-Kisani thotë: *“Lejohet Mudarebeja (bashkëpunimi me kapital nga njëra palë dhe me punë nga pala tjetër) midis Ehli Dhimes dhe muslimanit, atij që të lufton (harbiut) dhe atij që ka marrë garanci për siguri prej teje (must'mini).”*

Pra këtu vihet re se juristët kanë bërë dallim mes ortakërisë që në origjinë merret me aktivitet të ndaluar dhe asaj që merret me aktivitet të lejuar, por që ortaku nuk ruhet nga transaksionet e ndaluara. E para është e ndaluar rreptësisht, ndërsa tjetra ka mosmarrëveshje fikhu që sillen mes lejimit, mospëlqimit dhe ndalimit që në zanafillë.

Si përfundim, themi se shoqëritë aksionere që kanë një aktivitet të lejuar në origjinë, por që posedojnë disa transaksione të ndaluara, dijetarët kanë mbajtur qëndrime të ndryshme, edhe pse në pjesën më të madhe të qëndrimeve ajo lejohet, si dhe janë shprehur për mospëlqim, ndërsa origjina e marrëdhënieve me të tilla shoqëri është e lejuar. Ndërsa ata që janë shprehur duke bërë dallimin mes marrëdhënieve të përgjithshme si shit-blerje, të punuarit aty dhe të qenurit aksioner për shkak se kjo sjell bashkëpunim dhe dhënie ndihme për gjynah, ndërsa marrëdhëniet e përgjithshme nuk përfshihen në dhënien e ndihmës, e kanë ndërtuar qëndrimin e tyre mbi një ixhtihad jo fort të detajuar, sepse kanë bërë një ndarje jo të argumentuar, për arsye se edhe bashkëpunimi i përgjithshëm përfshihet në dhënien e ndihmës për gjynah. Kështu, punëtori i sigurisë, nëpunësi në zyrat e shoqërisë që tregohet i kujdesshëm për suksesin e shoqrisë japin një ndihmë akoma dhe me të madhe (në gjynah) se aksioneri në këtë shoqëri për disa ditë apo për disa orë pa marrë asnjë të ardhur prej shoqërisë. Aksioneri, si dhe bashkëpunëtori me shoqërinë, që të gjithë ndihmojnë (për gjynah), por për shoqëritë që kanë një aktivitet dhe para të lejuara në origjinë themi se lejohet të punohet aty dhe të jesh aksioner i saj, siç janë nëpunësit, punëtorët e shoqërisë së energjistikës dhe telekomunikacionit, gjithashtu edhe aksionerët e saj.

Përsa i përket qëndrimit se ndalimit të pjesëmarrjes në shoqëritë aksionere me kapital të përzier për arsyen se një pjesë e investimeve të saj janë të ndaluara, siç janë kamata dhe se aksioneri në shoqërinë që merret me transaksione me kamatë ndihmon për kamatë, qoftë e shumtë ose e pakët, themi se njihet fare nëpërmjet teksteve fetare se çifutët janë njerëzit që merren më shumë me transaksionet e ndaluara, siç është kamata, mashtrimi etj. dhe për këtë arsye Allahu thotë për ta në Kuran:

“Hanë pasurinë e fëlliqur” (El-Maide), pra edhe pse pasuria e çifutëve është e tillë, i dërguari i Allahut a.s. dhe shokët e tij nuk u mjaftuan me marrjen dhe dhënien nga çifutët, dhe pranimin e dhurateve prej tyre, por i dërguari i Allahut morri pjesë bashkë me ta (çifutët) në ngritjen e një shoqërie bujqësore në zonën e Hajberit, ku i dërguari i Allahut a.s. vuri në dispozicion tokat dhe pusët si kapitale materiale, ndërsa çifutët ofruan pasurinë dhe eksperincën e tyre për manaxhimin e e tokës. Kështu, i dërguari i Allahut a.s. ra dakort që fitimi të ndahet përgjysëm 50% për çdo palë, ashtu siç është shënuar te dy librat e saktë në hadithin e Ibn Omerit r.a. se i dërguari i Allahut a.s. ofroi për çifutët e Hajberit hurmat dhe tokën e Hajberit, me kusht që ta vënë në punë me pasurinë e tyre dhe që të dërguarit të Allahut t'i përkiste gjysma e fruteve të saj.” (Buhari 2285 dhe Muslimi 1551).

Gjëja më me vlerë që përfitohet prej këtij hadithi është fakti se i dërguari i Allahut ka bërë ortakëri me çifutët në pasurinë e tyre dhe nën administrimin e tyre, si dhe ata kishin pushtetin e plotë për të manovruar me marrëveshjet që kishin lidhje me punimin e tokës, drejtimin e saj etj, pavarësisht se ata nuk ruheshin nga transaksionet e ndaluara, siç tregohet në tekstet fetare dhe në provat e tërthorta në marrëdhëniet me ta.

Interesi i zhvillimit në të tilla raste lidhet me zhvillimin e ekonomisë së muslimanëve dhe për këtë arsye, feja jona e urtë ka toleruar në disa marrëdhënie deri diku jo të mira, për të realizuar një qëllim fetar akoma dhe më të madh, që ka të bëjë me interesin e përgjithshëm të muslimanëve.

Sipas kësaj që thamë, na bëhet e qartë se në shoqëritë me kapital të përzier lejohet pjesëmarrja dhe bërja aksioner, me kusht që transaksionet e ndaluara të jenë të pakta dhe me kusht që investitori të bëjë pastrimin e përvitçëm të fitimeve të ndaluara, dhe në rast se nuk e di sesa mund të jenë, atëherë mund të pastrojë 5% të tyre. Kjo i mjafton sipas mendimit të disa dijetarëve, me nijetin e pastrimit nga harami dhe jo dhënien e sadekasë. Allahu është Ai që jep mbështjeten.

Rregulla rreth agjërimit

Agjërimitin e Ramazanit e ka detyrë çdo mysliman, që ka arritur moshën e pjekurisë (pubertetin), i cili është i shëndoshë fizikisht e mendërisht dhe është rezident (jo udhëtar) në një vend. Kjo do të thotë se agjërimitin nuk e kanë detyrë:

1. Fëmijët të cilët nuk kanë mbushur moshën e pjekurisë.
2. Njeriu me të meta mendore.
3. I sëmurë që vuan nga sëmundje të përhershme ose pashërueshme. Ky gjykim vlen edhe për pleqtë e thyer në moshë të cilët nuk mund ta mbajnë dot agjërimitin. Ndërsa personat e sëmurë përkohësisht e ndërpresin agjërimitin për aq ditë sa janë sëmurë dhe pastaj i agjërojnë ato kaza kur të bëhen mirë.

Në këtë kategori futen edhe gratë me barrë të cilat kanë frikë përkeqësimit e shëndetit të tyre ose të foshnjës në bark, si dhe gruaja gjdhënëse e cila ka frikë për shëndetin e saj apo të fëmijës së vogël. Të dyja këto kategori mund ta ndërpresin agjërimitin dhe ta zëvendësojnë atë me vonë.

4. Gruaja me cikël menstrual dhe gruaja lehonë. Ato duhet t'i zëvendësojnë ato ditë më pas.

5. Udhëtarit, i cili udhëton udhëtime të gjata, mirëpo ai duhet t'i zëvendësojë ato ditë kur të kthehet nga udhëtimi.

SHËNIM: Të sëmurët, gratë me menstruacione dhe udhëtarët nuk e kanë detyrë t'i zëvendësojnë ditët menjëherë, por kanë kohë derisa të vijë Ramazani tjetër.

ÇFARË E PRISH AGJËRIMIN:

1. Të ngrënë dhe të pirët me qëllim: Këtu futen edhe ilaçet apo cdo lloj sendi tjetër i cili kalon në bark nëpërmjet fytit. Ndërsa ai që ha ose pi me harresë ose është i detyruar, nuk e ka prishur agjërimitin dhe nuk e ka detyrë ta kompensojë. Profeti

(alejhissalatu uesselam) thotë: *“Kush ha edhe pi gjatë agjërimit me harresë le ta vazhdojë agjërimitin se atë e ka ushqyer Allahu i Lartësuar.”* Transmetuan Buhariu dhe Muslimi.


2. Marrëdhëniet seksuale me vetëdije.
3. Të vjellurit me qëllim, pra duke e provokuar atë.
4. Dalja e gjakut te femra për arsye menstruale apo të lindjes. Edhe në qoftë se kjo ndodh pak çaste para se të perëndojë dielli ajo duhet ta zëvendësojë atë ditë më pas.
5. Ejakulimi i spermës, nëpërmjet ngacmimeve vetjake apo të huaja, apo fërkimeve, puthjeve etj.
6. Ikja e mendjes apo të rënit të fikët.
7. Futja e ujit në bark gjatë abdesit si pasojë e neglizhencës.
9. Pirja e duhanit.

ÇFARË NUKE PRISH AGJËRIMIN:

1. Të ngrënë, të pirët dhe marrëdhëniet seksuale me harresë.
2. Të vjellët pa provokim.
3. Futja e pluhurit, grimcave të rërës apo e ndonjë insekti pa dashje në në bark.
4. Përdorimi i misvakut nuk e prish agjërimitin apo pastrimi i dhëmbëve me furçë ose shpëlarja e gojës me ujë duke pasur kujdes që të mos kalojë në bark.
5. Përdorimi i gjilpërave joushqyese për trupin, të cilat vendosen në damar ose në mish:
6. Përcjellja e pështymës ose e ushqimit që ka mbetur ndërmjet dhëmbëve, nëse (ushqimi) është shumë pak.
7. Puthja e gruas, prekja, përqaftimi etj, kur njeriu arrin të përmbahet nga ejakulimi i spermës.
8. Provimi i shijes së ushqimit duke mos lejuar të kalojë gjë në bark.
9. Shkulja e dhëmbëve ose kurimi i tyre, në qoftë se lëndët e përdorura nga mjeku nuk arrijnë në fyt.

A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



www.lidhjatregtareve.com



GROUP

ALM GROUP TIRANE

Na kontaktoni:
Cel: 0684000401

Hobby Shampon me

EKSTRAKTE TË HUDHRËS

ndihmon në parandalimin e rënies së flokëve.
Forcon rritjen dhe mbron atë gjatë përdorimit
të rregullt të shamponit.



PRODUKTE NATYRALE



Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Jeni të mirëpritur!

Në dyqanin tonë do të gjeni:

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el-Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

**Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë xhamisë
"Dine Hoxha", Tiranë**

Cel: 0672812607 / 0672821589